

GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, SEZONI 2025/2026

(java e gjashtëmbëdhjetë, deri më 19.04.2026)


TË DHËNA JAVORE

Gjatë javës së gjashtëmbëdhjetë të vitit 2026 (nga 13-19.04.2026) në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar 109 ($I=5,9/100.000$) raste të të prekurve nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, për 24,8% më pak se javën që shkoi (145).

Në javën e gjashtëmbëdhjetë të vitit të kaluar janë regjistruar 155 të sëmurë (rënie për 29,7%), ndërsa krahasuar me modelin për 15 sezonet e fundit (60) është regjistruar një rritje prej 83,1%.

Incidenca e aktivitetit sezonal të virusit të gripit gjatë javës së gjashtëmbëdhjetë është në kufirin e aktivitet jashtësezonal të virusit të gripit.

Grafiku 1. Intensiteti dhe shpërndarja javore e të sëmurëve nga gripi/sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemiologjike 2010-2025, sezoni 2024/2025 dhe sezoni 2025/2026



Sa i përket grupmoshës, tek grupmosha nga 15-64 vjet janë regjistruar 58 të sëmurë, ndërsa tek grupmosha mbi 65 vjet – 19, tek grupmosha 5-14 vjet - 16 dhe tek grupmosha 0-4 vjet – 16 të sëmurë. Incidencë më e lartë (16,6/100.000) është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet.

Personat e sëmurë të kësaj jave janë regjistruar në 10 QSH/NJR, pra në Shkup – 38, Prilep – 31, ndërsa në 8 qytete numri i të sëmurëve është nën 10. Në qytetet e tjera nuk janë raportuar raste të të sëmurëve nga gripi.

Mbikëqyrja virologjike

Gjatë javës së gjashtëmbëdhjetë të raportimit pranë pranë laboratorit të virologjisë të ISHPRMV-së kanë arritur 37 materiale për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuara për Influenza, SARS-CoV-2 dhe/ose RSV.

Nga materialet e testuara nuk janë regjistruar raste pozitive për prani të virusit të gripit.

Janë regjistruar edhe 7 raste pozitive me RSV.

MBIKËQYRJA EPIDEMIOLOGJIKE - TË DHËNA KUMULATIVE


Gjatë sezonit 2025/2026 numri i përgjithshëm i të prekurve nga gripi/sëmundje të ngjashme me gripin është **16.976 (I=924,3/100.000)**.

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=25.768) numri i rasteve të raportuara është zvogëluar për 34,1%, ndërsa krahasuar me modelin për 15 vitet e fundit (n=20.673) është regjistruar një rënie prej 17,9%.

Të sëmurë janë regjistruar në të gjitha QShP/NjR. Numri më i madh i të sëmurëve (n=5.549) është regjistruar në Shkup, ndërsa incidencë më e lartë kumulative (I=2.733,6/100.000) në Dibër (n=523).

Sa i përket shpërndarjes të të sëmurëve sipas grupmoshës, numri më i madh i të sëmurëve bëjnë pjesë në grupmoshën që përfshin numrin më të madh të popullatës (nga 15-64 vjet) – 9.866 raste (58,1%), ndërsa incidencë më e lartë (2.049,3/100.000) është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet dhe 5-14 vjet (1.338,3/100.000).

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve me grip sezonal sipas QSH/NJR dhe incidenca në 100.000 banorë, sezoni 2025/2026



Shpërndarja e rasteve sipas muajve:

- tetor – 338 raste ose 2,0%
- nëntor – 438 raste ose 2,6%
- dhjetor – 1.324 raste ose 7,8%
- janar – 9.135 raste ose 54,9%
- shkurt – 4.336 raste ose 25,5%
- mars - 861 raste ose 5,1%
- prill – 364 raste ose 2,1%

Deri më tani janë regjistruar 4 raste të vdekjes si pasojë e gripit.

MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE – TË DHËNA KUMULATIVE

Deri më tani në sezonin 2025/26, pranë laboratorit të virologjisë në Institutin e Shëndetit Publik të RMV-së kanë arritur 1.257 materiale nga mbikëqyrja rutinore dhe SARI për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuar për Influenza, SARS-CoV-2 dhe/ose RSV.

Janë zbuluar 126 raste pozitive të gripit:


- **Influenza A – 126**
 - Influenza A(H1)pdm09 – 41 (32,5%)
 - Influenza A(H3) – 70 (55,6%)
 - Influenza A – e pasubtipizuar – 15 (11,9%)

○ Influenza B – 0

Janë regjistruar 26 rezultate pozitive për SARS-CoV-2 dhe 153 pozitive për RSV.

Janë detektuar edhe 5 viruse të tjerë respiratorë tek mostrat e testuara.

Grafiku 2. Shpërndarja javore e numrit dhe përqindjes të mostrave pozitive të gripit, mbikëqyrja rutinore dhe sentinel, RMV, 2025/2026



KOMENT EPIDEMIOLOGJIK

Incidenca e raportuar është në kornizat e aktivitetit jashtësezonal. Rezultatet e fituara nga mbikëqyrja virologjike tregojnë se nuk ka aktivitet të virusit të gripit. Përqindja e rasteve pozitive për me shumë javë me radhë është mbi 10%.

Sipas të dhënave të pranuar në Maqedoni ka një intensitet të ulët të virusit të gripit.

VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i shëndetit publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

- ❖ Për sezonin 2025/2026, Ministria e shëndetësisë siguroi 80.000 doza të vaksinë katërvalente falas për grupet prioritet të popullatës.

Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2024/2025 filloi në 16.10.2024 dhe zbatohet në Shtëpitë e shëndetit dhe/ose Qendrat e shëndetit publik me Njësitë e tyre rajonale. Vaksinimi i punonjësve shëndetësorë do të bëhet në Institutin e Shëndetit Publik. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes www.vaksinacija.mk.

Sipas të dhënave të Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike, nga fillimi i vaksinimit e deri në përmbylljen e këtij raporti **gjithsej janë vaksinuar 77.281 persona të kategorive të cënueshme të popullatës me vakcina falas.**

- ❖ 2.400 vakcina komerciale shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të shëndetit publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e Shëndetit Publik dhe Njësitë e tyre rajonale.

Sipas të dhënave të Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike **me vakcina komerciale janë vaksinuar gjithsej 1.843 persona.**

Në Maqedoninë e Veriut janë vaksinuar gjithsej 79.124 persona me vakcina falas dhe vakcina komerciale.

RAJONI EVROPIAN

*Burimi: <https://erviss.org/>

Sipas Raportit të ERVISS të publikuar në javën e pesëmbëdhjetë të vitit 2026:

- Shkalla e morbiditetit të gripit (ILI) dhe /ose infeksioneve respiratore akute (ARI) është rritur mbi nivelet bazë në 1 nga 32 vendet rajonit evropian të OBSH-së që raportojnë.
- Qarkullimi i virusit të gripit është në nivel messezonal në numrin më të madh të vendeve që raportojnë të dhëna.
- Indikatorët rajonalë për SARS-CoV-2 mbeten në nivele bazike.
- Përqindja e rasteve pozitive të RSV mbetet e lartë, por numri i testeve dhe rasteve pozitive të regjistruara vazhdon të bjerë në nivel rajonal. Fëmijët në moshë nën 5 vjet vazhdojnë të përfaqësojnë ngarkesën më të madhe të RSV.

***Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse
Instituti i Shëndetit Publik***